

STATUTI**SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"MESLANI AUDITING" SHPK**

KREU I PARË
Pjesa e përgjithshme

Neni 1

Shoqëria tregtare "MESLANI AUDITING" SHPK sot ne daten 11.03.2022, zotrohet nga ortaku i vetem si me poshte:

Z. Edrian Meslani, shtetas Shqipetar i biri i Hetem dhe i Violetes, i datëlindjes 04.10.1983, lindur në Tirane dhe banues në Rr. Tish Daia, Kompleksi Hawaii, kulla II, Ap. 39, Tirane, mbajtës i ID 1310040280, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

I cili me vullnetin e tij të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", ka vendosur të japi kontributin e tij sipas përcaktimeve që parashikohen në këtë statut për arritjen e objektivave ekonomikë duke destinuar në një sipërmarrje pasuri të tij me qëllim që të ndajë fitimet ose që të mund të përfitojë nga të ardhurat që rrjedhin prej saj.

Forma, emërtimi, selia , kohëzgjatja**Neni 2**

1. Shoqëria tregtare është e organizuar si shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe do të te mbajë emërtimin : "MESLANI AUDITING" SHPK

2. Ortaku i kësaj shoqërie merr përsipër që të paguaje pjesen që i takon nga humbjet e aktivitetit tregtar në këtë shoqëri.

3. Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare mund të ruhet i njëjtë emërtim me kusht që personi juridik të shfojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

Neni 3

Shoqëria tregtare "MESLANI AUDITING" SHPK do të përbushë objektin veprimtarisë së vet me një afat të pacaktuar kohe. Ky afat mund të ndryshohet me vendim të Asamblese te Ortakut te Shoqerise, sipas rregullave të parashikuara në këtë statut dhe legjisacionin shqiptar në fuqi.

Forma, emërtimi, selia , kohëzgjatja

Neni 4

1. Shoqëria tregtare "MESLANI AUDITING" SHPK ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në qytetin e Tiranës në adresë: Rr. Tish Daia, Kompleksi Hawai,kulla II, Ap. 39, Tirane.
2. Shoqëria tregtare "MESLANI AUDITING" SHPK pas përfitimit të personalitetit juridik mund të marrë masa për të patur një adresë interneti si dhe një postë elektronike për komunikim. Këto adresa do të janë të vlefshme për të tretët vetëm pasi t'i janë njoftuar Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me pikën 2 të nenit 69 të Ligjit Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
3. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjenci në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.
4. Ajo mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
5. Njësitë strukturore të shoqërisë në format e mësipërme do të krijohen në përputhje me legjislacionin shqiptar kur ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendit ku personi juridik ka qendrën e vet.
6. Shoqëria do të ketë vulën e saj dhe logon e saj. Ajo do t'i përdorë ato vetëm pas fitimit të personalitetit juridik në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi. .

Neni 5

1. Shoqëria tregtare "MESLANI AUDITING" SHPK fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit te saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".
2. Ndryshimet e Shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një personaliteti juridik të ri.

Neni 6

Shoqëria tregtare "MESLANI AUDITING" SHPK ka si objekt te veprimtarisë se saj:

1. Auditimin ligjore , te te gjitha llojeve te shoqerise private apo publike .
2. Revisionimin kontabel, assistencen ne fushen ekonomike, organizative, administrative, kontabel dhe fiskale, trajnimin dhe formimin profesional si dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimeve te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin Shqipetar ne fuqi.

3. Mund të hyje në tratativa dhe biznese me shoqëri te tjera që kanë të njëjtin objekt veprimtarie për të realizuar fitime në fushën e aktivitetit të saj;
4. Të marrë pjesë në ankande apo tendera të zhvilluara nga organet përkatëse shtetërore

Neni 7

Shoqëria tregtare "MESLANI AUDITING" SHPK nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industriale që ortakët zhvillojnë në mënyrë të pavarur prej saj.

(Kapitali)

NENI 8

1. Shoqëria tregtare "MESLANI AUDITING" SHPK do të kete kapital themeltar prej 100 (njëqind) lekë, e cili ndahet ne 1 (nje) kuote qe zotërohen nga ortaku i shoqerise:

- z.Edrian Meslani i cili zotron 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise e perbere nga 1 (nje) kuote ne vleren 100 (njeqind) Lekë

Neni 9

1. Në bazë të pjesëmarrjes së kapitali themeltar në shoqëri, fitimi i shpërndahet Ortakut te shoqerise në raport me kuotat e zotëruara. Këto fitime i shpërndahen Ortakut te shoqerise, vetëm nëse pas pagimit të dividientit :

- a) Aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve.

2. Në rast të plotësimit të kushteve të sipërpërmendura në këtë nen, nga ana e administratorit të shoqërisë lëshohet një çertifikatë që tregon aftësinë paguese të shoqërisë. Në të kundërt një çertifikatë e tillë nuk mund të lëshohet. Lëshimi i një certifikate të tillë në kundërshtim me këtë nen, ngarkon administratorin me përgjegjësi.

3. Të ardhurat neto qe do të rezultojnë nga bilanci i miratuar nga Asambleja e Ortakut do të shpërndahen si vijon :

- a) 5 % përfondin rezervë, deri sa ky fond të arrijë 1/5 e kapitalit themeltar;
- b) pjesa tjeter i shpërndahet Ortakut te shoqerise në raport me pjesëmarrjen e tij në kapitalin themeltar.



Neni 10

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera të veçanta të financimit për zhvillimin ekonomik e tregtar. Krijimi i një foni të tillë, bëhet gjithmonë me vendim të Asamblese se Ortakut te shoqerise .

Neni 11

1. Përberja e kapitalit të shoqërisë, fonde e krijimit të saj si dhe përdorimi e rregullimi i çdo foni të veçantë përcaktohen nga organi përkatës sipas të drejtave dhe detyrave të përcaktuara në statut.
2. Të ardhurat e përgjithshme të shoqërisë dhe në përgjithësi çdo operacion finansiar i saj do të pasqyrohen në kontabilitetin e shoqërisë sipas legjislativit të fuqi dhe në mbështetje të akteve përkatëse të rrjedhura prej tij.

Neni 12

1. Shoqëria tregtare "MESLANI AUDITING" SHPK është pronare e pasurisë se saj te cilën e përdor dhe e disponon atë ne emër te saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë.
2. Shoqëria është e lirë të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale në përputhje me legjislativin përkatës shqiptar.
3. Të gjitha shpenzimet për ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistencë teknike e juridike paguhen nga fonde e shoqërisë.

Neni 13

1. Pasuritë e shoqërisë vlerësohen në monedhë shqiptare.
2. Aktiviteti finansiar i shoqërisë do të mbylljet me 31 Dhjetor të çdo viti dhe bilanci do të miratohet brenda tre muajve të vitit në vazhdim.
3. Llogaritë vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit finansiar, raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga audituesi ligjor miratohen me Vendim të Asamblese se Ortakut te Shoqerise.

Neni 14

1. Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme ne rruge trashëgimie. Ato janë lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarje pasurore midis bashkëshortëve si dhe ndërmjet pasardhësve dhe paraardhësve.
2. Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes së ortakut gjëzon të drejtat e titullarit të cilat do ti kishte ai. Por amra me përashtim të faktit që përparrë se të realizohet ky regjistrim i kuotës duhet patjetër të bëhet dorëzimi përkatës.

Neni 15

Transferimi i pjesëve te kapitalit themeltar me trashëgimi ose brenda familjes personave përfitues do të bëhet pasi ata të pranojnë përbajtjen e statutit te kësaj shoqërie tregtare me gjithë ndryshimet që ai mund të ketë pësuar deri në momentin që këto pjesë të kapitalit themeltar bëhen të transferueshme.

Neni 16

1. Në rast mospranimi pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me miratimin nga Asambleja e Ortakut te Shoqerise.
2. Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim.
3. Transferimi i tyre, merr vlerë vetëm pas regjistrimit të kalimit të kuotave pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 17

1. Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributave ne natyre apo zvogëlimi i tij behet me miratimin e Asamblesë se Ortakut mbi bazën e një projekti te paraqitur nga audituesi ligjor dhe me kërkesën qofte edhe te njërit prej Ortakut themelues.

Neni 18

1. Asambleja e Ortakut te Shoqerise , mund të vendosë që rritja e kapitalit të bëhet dhe me rezervat dhe fitimet e pashpérndara të shoqërisë, gjendje të cilat figurojnë deri në datën 31 dhjetor të vitit/viteve financiar/financiare paraardhës/paraardhëse. Kjo gjë bëhet vetëm pasi Asambleja e Ortakut te Shoqerise, me vendim të ketë miratuar llogaritë vjetore të shoqërisë për vitin/vitet e mbyllur/mbyllura financiar/financiare paraardhës /paraardhëse.
2. Pas marrjes së një vendimi të tillë, Asambleja e Ortakut te Shoqerise cakton një auditues ligjor për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashpérndara të shoqërisë, gjendje të datës 31 dhjetor të vitit paraardhës.
3. Pas prezantimit të aktit të vlerësimit nga audituesi ligjor, Asambleja e Ortakut te Shoqërisë, me një vendim tjetër, përcakton mënyrën e rritjes së kapitalit themeltar të shoqërisë.
4. Pas marrjes së vendimit të dytë nga Asambleja e Ortakut te Shoqerise , e gjithë procedura e ndjekur në zbatim të këtij neni do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit parashikimeve të Ligjit Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

**KREU I DYTE
Ortakëria****Neni 19**

1. Asambleja e Ortakut te Shoqerise, me rezervat dhe fitimet e pashpérndara të ortakut, varetëzët e kompanisë, me miratimin e një projektit te paraqitur nga audituesi ligjor, do të paraqitet një vendim që i dhë një vlerësimin e rritjes së kapitalit themeltar të shoqërisë, që do të paraqitet deri në datën 31 dhjetor të vitit/viteve financiar/financiare paraardhës/paraardhëse. Kjo gjë bëhet vetëm pasi Asambleja e Ortakut te Shoqerise, me vendim të ketë miratuar llogaritë vjetore të shoqërisë për vitin/vitet e mbyllur/mbyllura financiar/financiare paraardhës /paraardhëse.
2. Pas marrjes së një vendimi të tillë, Asambleja e Ortakut te Shoqerise, me një vendim tjetër, përcakton mënyrën e rritjes së kapitalit themeltar të shoqërisë, që do të paraqitet deri në datën 31 dhjetor të vitit paraardhës.
3. Pas prezantimit të aktit të vlerësimit nga audituesi ligjor, do të paraqitet një vendim që i dhë një rritje të kapitalit themeltar të shoqërisë, që do të paraqitet deri në datën 31 dhjetor të vitit paraardhës.
4. Pas marrjes së vendimit të dytë nga Asambleja e Ortakut te Shoqerise, e gjithë procedura e ndjekur në zbatim të këtij neni do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit parashikimeve të Ligjit Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Ortakëria për shoqerinë tregtare "MESLANI AUDITING" SHPK krijohet dhe mbështetet në statutin e kësaj shoqërie dhe në ligj.

Neni 20

Shoqëria Tregtare "MESLANI AUDITING" SHPK, ka vetëm një ortak, të drejtat dhe detyrimet e të cilit përcaktohen në këtë statut dhe në Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 21

Ortaku i shoqërisë tregtare "MESLANI AUDITING" SHPK gjëzon të gjitha të drejtat dhe marrin përsipër detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës se Shqipërisë e ne Statutin e shoqërisë.

Neni 22

Të drejtat dhe detyrat e Ortakut te shoqerise :

- Te marrin pjese ne mbledhjet e Asambles se Ortakut;
- Te paraqesin pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë;
- Te informohen mbi përbajtjen e raportit te administritmit, inventarët e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, e raportin e audituesit ligjor;
- Të përfitoje nga fitimi i shoqërisë;
- Të kërkojn prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuarë;

KREU I TRETË Organizimi i shoqërisë

Neni 23


Shoqëria tregtare "MESLANI AUDITING" SHPK ka si struktura drejtuese :

- Asamblen e Ortakut te Shoqerise si organi vendimmarrës për shoqerinë;
- Administratoret e shoqerise

Neni 24

1. Asambleja e Otakeve te Shoqerise , si organ vendimmarrës për shoqerinë, është përgjegjës përmarrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të audituesve ligjor;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;



- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e Ortakut te Shoqerise merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës "1" të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

3. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakut te Shoqerise do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Forma e regjistrat dhe mbajtja e vendimeve përcaktohen me vendim të Asambles se Ortakut te Shoqerise. Asambleja e Ortakut te Shoqerise, me vendim, mund të ngarkojë dhe një person fizik për mirëmbajtjen e regjistrat të mbledhjeve.

4. Nga ana e Asambleja e Ortakut te Shoqerise merren të gjitha masat përkatëse për regjistrimin e vendimeve të saj pranë organeve përkatëse shtetërore dhe sidomos në veçanti, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- d) vendimet e marra në zbatim të nenit 18 të këtij statuti.

5. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 25

1. Mbledhja e Asambles se Ortakut te Shoqerise zhvillohet në rastet e përcaktuara nga Ligji Nr. 9904 datë 14. 04. 1999 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e Asambles se Ortakut te Shoqerise thirret dhe zhvillohet të paktën një herë në vit.

2. Mbledhja e Asambles se Ortakut te Shoqerise thirret kryesisht nga ortaku/ortaket e shoqerise, administratorët apo dhe nga Audituesi Ligjor kur ka nevojë për diskutime për çështje ekonomike që lidhen me shoqërinë.



3. Mbledhja e Asambles se Ortakut te Shoqerise thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.

4. Mbledhja e Asambles se Ortakut te Shoqerise thirret nga personat e tjerë të parashikuar nga pika 2 e këtij neni jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar në mbledhjen e Asambles se Ortakut te Shoqerise. Mënyra e thirrjes së Asamblesë bëhet sipas përcaktimeve përkatëse të parashikuara në nenin 83 të Ligjit Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 26

1. Administrimi i shoqërisë "MESLANI AUDITING" SHPK kryhet nga Administratori, i cili emërohen nga Asambleja e Ortakut te shoqerise. Administratoret mund te jene dhe person fizik jashtë shoqërisë.

2. Administratori i shoqërisë i emëruar nga Asambleja e Ortakut te Shoqerise eshte:

- Z. Edrian Meslani me afat 5 vjeçar.

3. Administratoret kane të drejta dhe detyrohen të:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqësojë shoqérinë tregtare;
- kujdeset përmbytjen e saktë e të regullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmirësuese, i paraqet këto dokumente përpara Asambles se Ortakut te Shoqerise për miratim;
- krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- raportojë përpara Asamblese se Ortakut të Shoqerise në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- përfaqësojë shoqérinë në marrëdhënie me të tretë;
- kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Z. Edrian Meslani me afat 5 vjeçar.

3. Administratoret kane të drejtë të detyrohen të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) kujdeset përmbytjen e saktë e të regullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

c) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmirësuese, i paraqet këto dokumente përpara Asambles se Ortakut te Shoqerise për miratim;


d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

e) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";

f) raportojë përpara Asamblese se Ortakut të Shoqerise në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

g) përfaqësojë shoqérinë në marrëdhënie me të tretë;

h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.



Edrian Meslani

Neni 27

1. Administratoret Jane përgjegjës sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje te ligjeve, për shkelje te Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Neni 28

1. Shoqëria Tregtarë "MESLANI AUDITING" SHPK emëron Auditues Ligjor.
 2. Emërimi kryhet nga Asambleja e Ortakut te Shoqerise.
 3. Për kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvëndësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimi i tij zbatohet legjislativisht shqiptar në fuqi.

Neni 29

Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi I tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në përputhje me legjislatin shqiptar në këtë fushë.

KREU I KATËRT**Bashkimi dhe ndarja e shoqërisë****Neni 30**

1. Shoqëria "MESLANI AUDITING" SHPK me anë të bashkimit mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ato themelojnë që ushtron te njëtin aktivitet.
 2. Gjithashtu shoqëria "MESLANI AUDITING" SHPK me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërise të reja.
 3. Në rast se operacioni përfshin krijimin e shoqërise të reja secila prej tyre themelohet sipas rregullave që i përkasin shoqërisë që do të krijohet.
 4. Transferimi i plotë i aktivit të shoqërisë apo kontributi në aktiv të një shoqërie tjetër, veçanërisht me anë të procesit të bashkimit duhet të autorizohet nga Asambleja e Ortakut te Shoqerise.

KREU I PESTË**Prishja dhe likuidimi i shoqërisë****Neni 31****PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

1. Shoqëria mund të prishet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkaku, si në rast falimentimi, privim të të drejtave për të ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktorë të tjera që nuk varen nga Ortakët.

2. Shoqëria hyn në fazën e likuidimit qysh në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Asambleja e Ortakut te Shoqerise emëron një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin asaj reportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit te Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe afatin e nevojshëm te përfundimit te tyre. Shoqëria prishet ne këto raste:

- Kur nuk mund të përbushet objekti për të cilin është krijuar shoqëria
- Me vullnetin e Ortakut
- Me vendim te Gjykatës
- Shkaqe të tjera të parashikuara në ligj

SHOQERIA "MESLANI AUDITING" SHPK - STATUTI

Neni 32

2022

1. Likuidimi i shoqërisë tregtare "MESLANI AUDITING" SHPK vendoset nga Asambleja e Ortakut te Shoqerise kur prishet shoqëria.

2. Likuidimi i shoqërisë do të bëhet duke zgjedhur procedurën e zakonshme të parashikuar në nenet 192 -203 të Ligjit Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 33

1. Në qoftë se Asambleja e Ortakut te Shoqerise, për mbylljen e parashikuar, nuk mund të marrë vendim ose nuk pranohet të miratohen llogaritë e likuiduesit vendimi merret nga Gjykata me kërkesën e likuiduesit ose çdo personi të interesuar.

2. Nëse nuk është proceduar si më sipër Gjykata me miratimin e Asambles se Ortakut te Shoqerise zbaton dispozitat ligjore dhe në se se miratimi nuk është dhënë deri në seancën e parë gjyqësore ky miratim prezumohet i mirëqenë.

Neni 34

Në fund të procesit të likuidimit thirret Asambleja e Ortakut te Shoqerise për të vodosur në lidhje me bilancin financier përfundimtar.



DISPOZITA TË FUNDIT**Neni 35**

1. Të gjitha mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.
2. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen në rrugë administrative çdo person i interesuar ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 36


Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe Legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 37

1. Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje origjinalë secili me të njëjtën vlerë ligjore.
2. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë

THEMELUESI**Ortaku i Vetem i Shoqerise**

Z. Edrian Meslani



Deri sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe Legjislacioni shqiptar në fuqi

Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje origjinalë secili me të njëjtën vlerë ligjore
Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë

Ortaku i Vetem i Shoqerise